



Federata e Paqes Universale
Një rrjet global paqebërësish

Botimi nr. 2
Dhjetor 2020

REVISTA E PAQES



CILA ËSHTË FEDERATA E PAQES UNIVERSALE?

Federata e Paqes Universale është themeluar më 12 shtator të vitit 2005 në New York, nga Dr. Son Mjong Mun dhe Hak Xha Han Mun, në praninë e qindra udhëheqësve nga e gjithë bota. Ajo është një aleancë globale e udhëheqësve të jetës politike, akademike, fetare, të shoqërisë civile, individëve dhe organizatave që i dedikohen ndërtimit të një bote bazuar te parimet themelore të Ndërvarësisë, Prosperitetit Reciprok dhe Vlerave Universale. Tashmë, Federata e Paqes Universale është OJQ me status të përgjithshëm konsultativ pranë Këshillit Social dhe Ekonomik të Kombeve të Bashkuara dhe rrjeti i saj i Ambasadorëve për Paqeshtrihet në mbi 160 vendetë botës. Në Shqipëri Federata e Paqes Universale është themeluar më 30 tetor 2005 në Pallatin e Kongreseve dhe tani ka 5000 Ambasadorë për Paqe të cilët janë pjesë e 61 Këshillave të Paqes në të gjitha bashkitë e vendit. Numri i personaliteteve që i janë bashkuar familjes së Ambasadorëve për Paqenë mbarë botën ka kaluar 150.000. Parimi i Ndërvarësisë nënkupton faktin që të gjithë njerëzit janë të ndërlidhur me njëri tjetrin në mënyrë të paevitueshme dhe e gjithë shoqëria njerëzore, si strukturë organike, është e destinuar të funksionojë në bazë të këtij parimi. Ky parim nënkupton gjithashtu faktin që çdo individ është unik në vetvete dhe secili ka prirje, dhunti dhe cilësi të veçanta të karakterit të vet dhe është ky diversitet i jashtëzakonshëm që na bën ne plotësues të njëri-tjetrit në nevojat, dëshirat apo aspiratat që kemi. Ndërkohë, nëse ne kuptojmë vlerën tonë të jashtëzakonshme që kemi si individ, atëherë do jemi të aftë të kuptojmë që të njëjtën vlerë kanë të gjithë njerëzit, pavarësisht dallimeve që ekzistojnë. Unë kam nevojë për të tjerët dhe të tjerët kanë nevojë për mua, dhe është pikërisht përmes shërbimit dhe kujdesit ndaj të tjerëve që unë mund të manifestoj vlerën time të vërtetë.

Nëse kuptohet, vlerësohet dhe aplikohet parimi i Ndërvarësisë, duke kuptuar vlerën unike të vetja dhe të çdo person tjetër, atëherë parimi i Prosperitetit Reciprok do praktikohet natyrshëm. Njerëzit në mënyrë të natyrshme do të jetonin për hir të njëri-tjetrit dhe do të ndihmonin ata që janë më në nevojë, dhe si rezultat ndarja e burimeve do të ishte më e drejtë dhe nuk do kishte një dallim kaq ekstrem midis të pasurve dhe të varfërve. Qeveritë do t'i ndërtonin politikat e tyre qeverisëse në interes të të gjithë shoqërisë, duke ruajtur dinjitetin njerëzor përmes politikave sociale nga njëra anë, dhe duke respektuar iniciativën e lirë dhe kreativitetin nga ana tjetër, përmes stimulimit dhe inkurajimit të individëve apo grupave të veçanta që do të çonin përpara zhvillimin e shkencës, artit, kulturës, teknologjisë etj. Kreministat dhe Ministrat, ashtu siç ka edhe kuptimin vetë fjala, do të ishin njerëzit më të aftë dhe me dëshirën më të madhe për të qenë krye-shërbëtorë dhe shërbëtorë të njerëzve, duke respektuar në maksimum besimin e njerëzve për t'i qeverisur. Në këtë rast ndarja e pushteteve do të ishte e qartë dhe ato do të kontrollonin dhe plotësonin njëri tjetrin, duke mos e cënuar në asnjë rast drejtësinë e vërtetë dhe dinjitetin njerëzor. E që të ndodhë kjo, duhet që të ekzistojnë dhe evidentohen disa Vlera Universale që janë të përbashkëta, të pranueshme dhe të aplikueshme nga të gjithë njerëzit dhe shoqëritë, pavarësisht dallimeve kombëtare, kulturore, fetare, racore apo gjinore. Këto Vlera Universale duhet të krijojnë bazën e përbashkët për të gjitha shoqëritë dhe kombet për t'u bërë bashkë duke krijuar ndjesinë e një familje njerëzore universale nën një Zot, duke sjellë me vete larminë e diversitetit të kulturave, traditave dhe besimeve të ndryshme, të cilat do t'ia shtojnë ngjyrat dhe bukurinë marrëdhënieve njerëzore.

PËRMBAJTJA

Asambletë e Këshillave Lokale të Paqes anembanë vendit	4
Krijimi i Këshillit Shqiptar të Paqes në Londër	5
Një delegacion nga Ballkani në Samitin 2020 - Seul, Kore	6
Përfaqësimi i Shqipërisë dhe Kosovës në aktivitete ndërkombëtare	8
Konferencë virtuale me Presidentët e Ballkanit	9
Përvjetori i 8-të i Rev. Dr. Son Mjong Mun	10
Përvjetori i 15-të i themelimit të Federatës së Paqes Universale	11
Asambleja e Federatës së Paqes Universale dhe zgjedhjet e reja	12
Përvjetori i Samitit të Paqes për Evropën Juglindore	14
Promovimi i librit të Dr. Hak Xha Han Mun, "Nëna e Paqes"	20
Konferencë virtuale me udhëheqës fetarë	22
Këshilli Shqiptar i Paqes Gjermani	23
Ambasadë e Paqes për Shqipërinë dhe Ballkanin	24

**STANDARTI MË I LARTË I JETËS
ËSHTË AI I TË JETUARIT PËR HIR
TË TË TJERËVE**



Asamblëtë e Këshillave të Paqes anembanë vendit

Pas Samitit të Paqes të tetorit 2019, Federata e Paqes nisi punën për thirrjen e Asambleve të Ambasadorëve për Paqe në secilin nga Këshillat e Paqes, në të cilat u bënë edhe zgjedhjet e radhës për drejtuesit e rinj të Këshillave të Paqes ose rikonfirmimi i drejtuesve edhe për dy vjet, në përputhje me statutin dhe rregulloren e FPU

Shqipëri. Rreth 2000 Ambasadorë për Paqe dhe të tjerë u bënë pjesë e asambleve të mbajtura nga dhjetori 2019 deri në mars 2020, kur vendi u mbyll nga pandemia e covid 19. Gjatë këtyre aktiviteteve 520 njerëz të rinj me vlera dhe kontribute të spikatura, morën titullin “Ambasador për Paqe” duke iu bashkuar familjes së madhe të paqes.



Krijimi i Këshillit Shqiptar të Paqes në Londër

Më 25 janar 2020 në mjediset e Federatës së Paqes Universale në Londër u mbajt aktiviteti për krijimin e Këshillit Shqiptar të Paqes për Mbretërinë e Bashkuar. Në aktivitet morën pjesë rreth 70 persona të ftuar, shqiptarë të afirmuar, të integruar tashmë dhe me kontribut në shoqërinë angleze. Aktivitetin e nderuan me pjesëmarrjen e tyre edhe Ambasadori i Shqipërisë në Londër z. Qirjako Qirko, Dr. Michael Balcomb – Kryetar i Federatës së Paqes për Evropën dhe Lindjen e Mesme, Z. Robin March – Kryetar i Federatës së Paqes për Anglinë, Dr. Mark Brann – Zv. President i Federatës së Paqes për Evropën dhe Dr. Gaqo Apostoli - Kryetar i Federatës së Paqes për Shqipërinë. Në fund të aktivitetit u nderuar 20 figura të shquara shqiptare, rezident në Mbretërinë e Bashkuar, u vlerësuan me titullin Ambasador për Paqe. Gjithashtu, u zgjodh edhe kryesia e Këshillit Shqiptar të Paqes për Anglinë e kryesuar nga z. Lavdrim Krashi dhe nënkryetarë znj. Adelina Badivuku dhe z. Përparim Rama.



Delegacion nga Ballkani në Samitin 2020 - Seul, Kore



Nga data 3 – 8 shkurt 2020 në Seul të Koresë së Jugut u mbajt Samiti Botëror i Paqes me temë “Ndërtimi i paqes botërore përmes ndërvarësisë, prosperitetit të ndërsjellë dhe vlerave universale”. I organizuar si kulmimi i një seri samitesh të sponsorizuar nga Federata e Paqes Universale gjatë vitit 2019 në të gjitha kontinentet e botës, në Samitin e Paqes 2020 morën pjesë rreth 6000 personalitete nga 170 vende të ndryshme, duke përfshirë kryetarë dhe ish kryetarë shtetesh dhe qeverish, parlamentarë, udhëheqës fetarë, laureatë të çmimit Nobel, gazetarë, akademikë dhe udhëheqës të rinj.

Gjatë Samitit u mbajtën asambljetë e Këshillit të Lartë Ndërkombëtar të Paqes, Organizatës Ndërkombëtare të Parlamentarëve për Paqe dhe Organizatës Ndërfetare për Paqe dhe Zhvillim. Gjithashtu u lançuan tri projektet e reja të FPU, Organizata Ndërkombëtare e Medies për Paqe, Organizata Ndërkombëtare e Akademikëve për Paqe dhe Organizata Ndërkombëtare për Zhvillimin Ekonomik.

Pjesë e rëndësishme të Samiti ishte edhe ceremonia e dhënies së Çmimit të Paqes Sun Hak, që këtë vit u akordua ish Sekretarit të OKB Bak Ki Mun, Presidentit të Senegalit Macky Sall dhe Kryepeshkopit palestinez Munib Younan, që është edhe president nderi i organizatën ndërkombëtare Fetë për Paqe.

Gjatë Samiti u mbajt edhe një seancë e veçantë konsultimi mbi Iniciativën për Paqe në Ballkan, ku referuan ish Presidenti Alfred Moisiu dhe ish Kryeministri Vilson Ahmeti nga Shqipëria, ish Presidenti Filip Vujanovic nga Mali i Zi, ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Anders Fogh Rasmussen, presidenti i Forumit për Studimet Strategjike në Serbi dr. Neven Cvetianin dhe specialisti i shkencave politike nga Franca z. Emmanuel Dupuy. Seanca u moderua nga Ambasadori Christopher Hill, ish Ambasador i SHBA në Shqipëri.

Delegacioni nga Shqipëria kryesohej nga ish Presidenti Alfred Moisiu dhe ish Kryeministri Vilson Ahmeti, dhe pjesë e tij ishin: Dr. Gaqo Apostoli dhe Prof. Dr. Mimoza Hafizi si ish parlamentarë; Dr. Saemira Gjipali, Prof. Selami Xhepa, Dr. Armand Vokshi dhe Dr. Arta Musaraj nga sfera akademike; z. Lutfi Dervishi, z. Mentor Kikia, z. Enton Abilekaj



dhe zj. Mirilda Tili nga media; z. Flamur Shehu, dr. Niko Veizaj, z. Ali Laçej, zj. Majlinda Mema, Dr. Astrit Memia, Dr. Eva Çipi, z. Abdulla Domi, zj. Flutura Kona dhe zj. Suzana Numani si përfaqësues të FPU dhe Këshillave të Paqes; dhe Sheh Hysen Hormova nga sfera fetare. Kosova përfaqësohej me ish deputetin z. Hydajet Hyseni, deputeten Besa Ahmeti, z. Skënder Krasniqi kryetar i Kosova Press dhe z. Binak Ulaj kryetar i FPU. Mali i Zi përfaqësohej nga ish Presidenti Filip Vujanovic, Sekretari i Përgjithshëm i Klubit të Podgoricës, z. Ruzdija Tuzovic dhe z. Sead Sahman, shef i kabinetit të Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale. Maqedonia e Veriut përfaqësohej nga z. Afet Mamuti pedagog në Tetovë dhe z. Halit Ajdini, zv. drejtor i agjencisë publike të medies MIA.



“

Mënyra e vetme për të zgjidhur të gjitha problemet e botës sot, është duke u bërë bij besnikë, bija besnike dhe patriotë të vërtetë përpara Prindit tonë Qiellor!

”



Përfaqësimi i Shqipërisë dhe Kosovës në aktivitete ndërkombëtare

Më datë 9 gusht 2020 Federata e Paqes Universale organizoi online aktivitetin madhështor **“Tubimi i Shpresës”** i cili u ndoq live nga 130 milionë njerëz në të gjithë botën. Në këtë aktivitet historik Shqipëria u përfaqësua nga Presidenti Alfred Moisiu.



[Kliko këtu për të ndjekur të gjitha fjalimet.](#)
[Kliko këtu për fjalimin e Dr. Gaqo Apostoli.](#)
[Kliko këtu për fjalimin e Sh. T. Albin Kurti.](#)
[Kliko këtu për fjalimin e Prof. Dr. Arben Malaj.](#)

Në datat 11 – 13 shtator 2020, Federata e Paqes Universale organizoi Konferencën Ndërkombëtare të Liderit me temë **“Mundësi dhe shpresë në një kohë krize globale: ndërvarësia, prosperiteti i ndërsjellë dhe vlerat e përbashkëta”**, duke sjellë së bashku udhëheqës dhe ekspertë me kontribut të veçantë në zhvillimet botërore, për të ndarë praktikat më të mira në lidhje me qasjen ndaj sfidave me të cilat po përballet sot e gjithë bota.

Pjesë e personaliteteve të nderuara që kontribuan në këtë konferencë ndërkombëtare ishin edhe Ambasadorë për Paqe nga Shqipëria dhe Kosova. Në ditën e parë të konferencës në seancën e Këshillit të Lartë Ndërkombëtar për Paqe referoi Sh.T. Albin Kurti, ish Kryeministri i Kosovës. Ditën e dytë të konferencës në seancën e mbajtur mbi 15-vjetorin e themelimit të Federatës së Paqes Universale referoi Dr. Gaqo Apostoli, kryetar i FPU Shqipëri. Në ditën e tretë në seancën mbi Krijimin e Prosperitetit të Ndërsjellë, referoi Prof. Dr. Arben Malaj, ish Ministër i Financave të Shqipërisë.

Konferencë virtuale me Presidentët e Ballkanit




Federata e Paqes Universale dhe Këshilli i Lartë i Paqes për Ballkanin, organizuan më 30 korrik 2020 konferencën virtuale me temë: **Ballkani Perëndimor: Përballja me sfidat historike dhe shfrytëzimi i mundësive që ka përpara.**

Panelistët e konferencës ishin 4 ish - presidentë të nderuar nga vendet e Ballkanit:

- Sh.T. Alfred MOISIU – President i Shqipërisë (2002 – 2007)
- Sh.T. Filip VUJANOVIĆ – President i Malit të Zi (2003 – 2015)
- Sh.S. Nataša MIĆIĆ – Presidente e Serbisë (2002 – 2004)
- Sh.T. Fatmir SEJDIU – President i Kosovës (2006 – 2010)

Konferenca u moderua nga Ambasadorja për Paqe, zj. Jolanda Trebicka, Presidente e Europartners Development. Pjesë e rëndësishme e konferencës ishin edhe komentet dhe pyetjet për panelistët nga 4 udhëheqës të rinj nga Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova.



[Kliko këtu për të ndjekur videon e eventit.](#)

“100 vjet Përkushtim”

Përvjetori i 8-të i ndarjes nga jeta e Rev. Mun

Edhe veprimi më i vogël që bëhet për hir të dikujt tjetër,
mund të sjellë gëzim të jashtëzakonshëm.

-Rev. Son Mjong Mun

100 vite përkushtim titullohej aktiviteti që u mbajt në mjediset e Hotel Tirana me rastin e përvjetorit të 8 të ndarjes nga kjo jetë e themeluesit të Federatës së Paqes Universale Dr. Son Mjong Mun. Rreth 120 Ambasadorë për Paqe, të ftuar të tjerë, të rinj dhe studentë u bënë bashkë për të nderuar kujtimin e jetës dhe veprës së Rev. Mun, Babait të Vërtetë. Pavarësisht faktit që u bënë 8 vite tashmë që nga kalimi i tij në botën tjetër, kujtimi i tij

mbetet ende shumë gjallë për shkak të shembullit të një jete plot dashuri për hir të të tjerëve. Në emër të Ambasadorëve për Paqe aktivitetin e përshëndetën znj. Lavdie Ruci dhe z. Gaqo Apostoli. Gjithashtu Dr. Aleks Sulejmani përshëndeti pjesëmarrësit në emër të Federatës së Familjes dhe z. Atdhe Zyrhanaj nga Kosova përshëndeti në emër të të rinjve. Të rinjtë mbushën atmosferën me dashuri përmes performancave artistike.



Përvjetori i 15 i themelimit të Federatës së Paqes Universale

Shtatori është muaji i lindjes së Federatës së Paqes Universale dhe këtë vit është 15 vjetori i themelimit të saj. 130 Ambasadorë për Paqe nga Shqipëria dhe Kosova u mbledhën në Hotel Tirana International për të përkujtuar këtë ditë historike. Aktiviteti u moderua nga Dr. Saemira Pino, anëtare e bordit të FPU dhe ish zëvendës ministre e Arsimit dhe e Shëndetësisë. Ajo vuri në pah kontributin e rëndësishëm që Federata e Paqes ka dhënë gjatë këtyre viteve në të gjithë botën dhe në Shqipëri. Kryetarja e Asamblesë Kombëtare të FPU znj. Rajmonda Stefa, ish deputete, përshëndeti pjesëmarrësit dhe prezantoi disa nga pikat kryesore të udhëtimit të FPU gjatë 15 viteve të fundit.

Në fjalën e tij, Presidenti Alfred Moisiu, Kryetar i Këshillit të Lartë për Paqen në Ballkan tha: “Unë e shpreh me krenari që kam qenë pjesë e udhëtimit të Federatës së Paqes Universale që nga viti 2005, kur themeluesit e saj, Rev. dhe Znj. Mun, vizituan Shqipërinë dhe i prita në rezidencën qeveritare në Durrës. Pas përfundimit të mandatit tim si President, me kënaqësi kam qenë pjesë e aktiviteteve kombëtare, rajonale dhe botërore duke u përfshirë në konferenca dhe samite të nivelit të lartë dhe them me bindje se Federata e Paqes Universale në këto 15 vjet ka arritur të bëhet një faktor ndikues në arenën ndërkombëtare.”

Ish Presidenti i Kosovës Fatmir Sejdiu në fjalën e

tij theksoi: “Besoj se është shumë e rëndësishme të shprehim vlerësimin tonë për punën e madhe që Federata e paqes ka bërë për Shqipërinë dhe Kosovën gjatë këtyre viteve. Më duhet të them se puna e FPU-së është e jashtëzakonshme. Kam marrë pjesë në shumë veprimtari ndërkombëtare dhe të gjitha kanë qenë të shkëlqyera, por gjithashtu duhet të jemi krenarë për aktivitetet e nivelit të lartë që kemi organizuar edhe ne këtu.”

Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Komunitetit Bektashi, në fjalën e tij të rastit tha: “Veprimtaritë e organizuara nga Federata e Paqes Universale me siguri do të mbahen mend për kohë të gjatë, jo vetëm për madhësinë, gjeografinë dhe temat që janë trajtuar, por sidomos për përmbajtjen e mesazheve të përcjella për të gjithë brezat.”



Asambleja e Federatës së Paqes Universale dhe zgjedhjet e reja



Më datë 26 shtator 2020, Federata e Paqes Universale mbajti Asamblesë e Ambasadorëve për Paqe në Tiranë. Asambleja u zhvillua me disa muaj vonesë për shkak të pandemisë. Asambleja u mbajt në Hotel Tirana dhe morën pjesë rreth 120 Ambasadorë për Paqe, Kryetarët e Këshillave të Paqes dhe personalitete të shquara.

Gjatë punimeve të Asamblesë u bë një analizë e punës së Federatës së Paqes gjatë 3 viteve të fundit dhe vlerësime për arritjet gjatë mandatit të fundit, i cili kulmoi me mbajtjen në Shqipëri të Samitit të Paqes për Evropën Juglindore.

Punimet e Asamblesë u moderuan nga Kryetari i Federatës së Paqes Universale Shqipëri z. Gaqo Apostoli. Vlerësime për punën e bërë dhanë z. Ali Laçej – Bashkëkoordinatori i Këshillit Shqiptar të Paqes, z. Lavdie Ruci – Kryetare e Këshillit të Paqes Tiranë (2017 – 2019), z. Myzaljen Hoxha – Kryetar i Këshillit të Paqes Fier (2017 – 2019), z. Flutura Kona – Kryetare e Këshillit të Paqes Durrës (2017 – 2019) dhe zj. Lulëzime Celami – Kryetare e Këshillit të Paqes Lezhë (2017 – 2019).



Në fund u zgjodh Kryesia e Asamblesë së Federatës së Paqes Universale për 2 vitet e ardhshme:

- zj. Rajmonda Stefa – Kryetare e Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri
- z. Niko Veizaj – Nënryetar i Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri
- z. Astrit Memia – Nënryetar i Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri
- zj. Majlinda Mema – Nënryetare e Asamblesë së Federatës së Paqes Universale Shqipëri

Dhe Kryesia e Këshillit Drejtues të Federatës së Paqes Universale Shqipëri:

- Zj. Eva Çipi – Kryetare
- Z. Flamur Shehu – Nënryetar
- Z. Abdulla Domi – Nënryetar
- Z. Myzaljen Hoxha – Nënryetar
- Zj. Nora Malaj – Nënryetare

Në fjalën e tij z. Gaqo Apostoli ndër të tjera tha:

“Fakti që Nëna Mun e shpalli vendin tonë si Shqipëria Qiellore është një vlerësim sa hyjnor aq edhe tokësor. Në këtë punë tërësore kuptohet që është merita e të gjithëve Ju që keni punuar me përkushtim, me dëshirë dhe dashuri, pa asnjë përfitim material, duke sakrifikuar pa kushte për hir të të tjerëve. Për këtë dua t’ju falënderoj me gjithë shpirt. Procesi i ndryshimeve në leadership do të rritë më tej energjitë individuale dhe kolektive, duke rritur sinergjinë e ekipit drejtues të Federatës së Paqes Universale”.



Në fjalën e saj kryetarja e re e Federatës së Paqes theksoi:

“Prindërit e Vërtetë janë dy njerëz që i kanë kushtuar gjithë jetën paqes botërore dhe pavarësisht kundërshtimit, refuzimit dhe persekutimit të padrejtë ajo që kanë arritur është pothuajse një mrekulli, do të thojë. Të gjithë ne duhet të ndihemi krenarë që jemi Ambasadorë për Paqen dhe në këtë kohë duhet të punojmë së bashku me Nënë Mun për të avancuar misionin e paqes. Dua t’ju falënderoj të gjithëve që më besuat udhëheqjen e Federatës së Paqes gjatë këtij mandati dhe besoj se do të punojmë së bashku si një ekip, ashtu siç kemi bërë deri më tani nën udhëheqjen e shkëlqyer të z. Apostoli”.



Një vit nga Samiti i Paqes për Evropën Juglindore

Mbi 400 pjesëmarrës nga 50 vende morën pjesë në Samitin e Paqes për Evropën Juglindore, të organizuar nga Federata e Paqes Universale në Tiranë, Shqipëri. Takimi i nivelit të lartë u mbajt nga data 25 deri më 27 tetor 2019. Seancën plenare të hapjes së Samitit e nderuan me praninë e tyre themeluesja e Federatës së Paqes Universale Dr. Hak Ja Han Moon; presidenti i Maqedonisë së Veriut, Sh.T. Stevo Pendarovski; presidenti i Kosovës, H.E. Hashim Thaçi; dhjetë ish-kryetarë shtetesh dhe qeverish dhe figura kryesore politike nga rajoni i Ballkanit. Më shumë se 70 parlamentarë dhe ministra të qeverive aktuale dhe të mëparshëm morën pjesë në seancat e Samitit. Me dhjetëra udhëheqës fetarë nga Evropa, Lindja e Mesme dhe Afrika ishin pjesë e Samitit. Komuniteti fetar shqiptar u përfaqësua nga z. Bujar Spahiu, kryetar i Komunitetit Mysliman; Baba Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve; znj. Nikki Doçi,

përfaqësuese e Aleancës Ungjillore Shqiptare; si dhe Dr. Genti Kruja, sekretari i përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë. Pesëmbëdhjetë organizata dhe institucione të rëndësishme ishin partnerë zyrtarë të samitit, si Bashkia e Tiranës, Klubi i Podgoricës i ish-kryetarëve të shteteve dhe qeverive të rajonit të Ballkanit, Këshilli i Paqes i Ukrainës, Urdhri Botëror Bektashi, Universiteti i Tiranës dhe organizata të tjera nga bota akademike dhe ajo e biznesit. Organizatat partnere të FPU-së përfshinin Fondacionin “Washington Times”, Federatën e Grave për Paqen Botërore (WFWP) dhe Akademinë Botërore Profesorëve për Paqe. Samiti i Paqes u zhvillua nën patronazhin e Kryeministrit të Shqipërisë. Komiteti organizues i samitit u bashkëkryesua nga Dr. Katsumi Otsuka, kryetari i FPU për Evropën dhe Lindjen e Mesme; Sh.T. Alfred Moisiu, President i Shqipërisë (2002-2007); dhe Haxhi Dede Edmond Brahimaj, Kryegjyshi Botëror i Bektashinjve.





Samiti i Paqes ishte një mbledhje e rëndësishme për udhëheqësit në Ballkan. Konfliktet politike në rajon janë të forta, qoftë brenda shteteve apo edhe ndërmjet shteteve, si rasti i Kosovës dhe Serbisë. Seanca e hapjes filloi me një seri fjalimesh mbi temën “Perspektivat për Paqen në Ballkan”, që u moderua nga Nënkryetarja e Kuvendit të Shqipërisë Prof. Dr. Vasilika Hysi. Fjala e parë u mbajt nga z. Talat Xhaferi, Kryetar i Asamblesë Kombëtare të Maqedonisë së Veriut, pasuar nga z. Albin Kurti, ish kryeministri i Kosovës dhe nga Ambasadori Christopher Hill, i cili ka shërbyer si ambasador i SHBA në Ballkan.

Laçimi i Këshillit të Lartë Ndërkombëtar për Paqen (ISCP), një iniciativë e FPU, filloi me një mesazh përshëndetës nga znj. Elisa Spiropali, ministrja shqiptare e Marrëdhënieve me Parlamentin e cila foli në emër të qeverisë shqiptare, nën patronazhin e të cilës u mbajt samiti. Ajo u pasua nga Sh.T. Stevo Pendarovski, presidenti i Maqedonisë së Veriut dhe nga Sh.T. Hashim Thaçi, presidenti i Kosovës. Më pas, Presidenti Alfred Moisiu dha një mesazh si bashkëkryetar i samitit, përpara se të prezantonte bashkëthemeluesen e Federatës së Paqes Universale, Dr. Hak Xha Han Mun.

Dr. Mun në fjalën e saj theksoi se megjithëse Shqipëria konsiderohej e fundit në Evropë, pas një



historie të gjatë vuajtjesh, kishte ardhur koha që e fundit të bëhej e para.

Tetë ish-kryetarë shtetesh nga kombet që kishin qenë në konflikt gjatë luftërave Ballkanike u ngjitën në skenë për të marrë një medalje themeluese të Këshillit të Lartë Ndërkombëtar për Paqe nga Dr. Mun: Presidenti Stjepan Mesić i Kroacisë (2000-2010); Kryeministri Hasan Muratović i Bosnjë-Hercegovinës (1992-1995); Presidenti Fatmir Sejdiu i Republikës së Kosovës (2006-2010); Kryeministri Mirko Cvetković i Republikës së Serbisë (2008-

“
Do të arrijmë sukses vetëm nëse e bëjmë paqen përgjegjësinë tonë parësore dhe mirëqenien e të gjithëve ne dhe të rajonit tonë qëllimin tonë primar të të gjithë politikanëve të përgjegjshëm.
 ”

Sh.T. Stevo Pendarovski

2012); Presidenti Zhivko Budimir i Republikës së Bosnjë-Hercegovinës (2011-2015); Ushtruesi i detyrës së presidentit Jakup Krasniqi i Republikës së Kosovës (2010-2011); Kryeministri Vilson Ahmeti i Republikës së Shqipërisë (1991-1992); dhe Kryeministri Bajram Kosumi i Republikës së Kosovës (2005-2006). Dr. Mun i kërkoi Presidentit Alfred Moisiu të drejtojë Këshillin e Lartë Ndërkombëtar për Paqen për rajonin e Ballkanit. Pasditen e datës 26 dhe paraditen e datës 27 tetor, u zhvilluan dhjetë sesione të Samitit në mjediset e Tirana International Hotel, ku morën pjesë rreth 400 personalitete nga 50 vende të botës. Një banket për 150 gra udhëheqëse për u organizua në mbrëmjen e 26 tetorit nga Federata e Grave për Paqe Botërore.



Në seancën e mbylljes së samitit, një audiencë prej afro 400 personash u bë pjesë e reflektimeve mbi “Perspektivat e Paqes në Evropën Juglindore” nga tre folës të shquar: Ministri austriak i Mbrojtjes Dr. Werner Fasslabend (1990-2000), Sh.T. Presidenti Bujar Nishani i Shqipërisë (2012-2017) dhe Dr. Michael Balcomb, kryetari i Federatës së Familjes për Paqe Botërore dhe Bashkimin (FFWPU) për Evropën dhe Lindjen e Mesme.

Një tjetër ngjarje kulmore e samitit ishte Festivali i Bekimit të Familjes ku morën pjesë përfaqësues nga të gjitha qytetet e Shqipërisë dhe 61 Këshillat e Paqes të krijuara dy vitet e fundit në të gjitha bashkitë e vendit. Pjesë e festivalit ishin 1.200 çifte të cilët u bënë pjesë e ceremonisë së ripërkushtimit në martë, që u drejtua nga Dr. Hak Xha Han Mun dhe që u transmetua live nga mediet. Afirmimi i rëndësisë së familjes si gur themeli i një shoqërie paqësore dhe të qëndrueshme, është në themel të vizionit dhe aktiviteteve të FPU-së. Dr. Mun u foli përsëri të pranishmëve për rëndësinë e forcimit të shoqërisë duke promovuar vlerat e familjes së vërtetë dhe dashurinë për kombin.



Do të vazhdojmë të ndërtojmë ura bashkëpunimi dhe afrimi ndërmjet popujve tanë, shteteve tona dhe tërë rajonit dhe botës; me projekte të përbashkëta për të qenë konkurrent më botën e zhvilluar në të gjitha aspektet sepse kemi potencialin njerëzor të duhur, kemi vullnetin e fortë dhe kemi mundësinë të bëhemi shembullorë.

-Sh.T. Talat Xhaferi



FJALA KRYESORE

Pjesë nga fjala e Dr. Hak Xha Han Mun në Samitin e Paqes në Evropën Juglindore 2019, më 26 tetor 2019.

Të respektuar krerë të tanishëm dhe të mëparshëm të shteteve, ambasadorë të paqes, udhëheqës fetarë, udhëheqës nga të gjitha fushat e shoqërisë dhe anëtarë të Federatës së Familjes për Paqe Botërore:

Në këtë ditë historike për Shqipërinë, dëshiroj të ndaj me ju një mesazh të rëndësishëm nga Zoti. Unë kam lindur në Gadishullin Korean, dhe sot qëndroj këtu, në kombin e Shqipërisë, në Gadishullin Ballkanik. Unë besoj se gadishujt janë toka vërtetë bekuara. Jo vetëm që mjediset natyrore janë me tërë mend të bukura, por popujt që jetojnë në këto rajone janë gjithashtu burra dhe gra të virtytshëm. Kur shikojmë historinë njerëzore, vëmë re se shumë njerëz të mirë dhe të virtytshëm kanë vuajtur. Zoti, pronari i universit, i krijoi të gjitha gjërat sipas shëmbëlltyrës së Tij. Pasi krijoi të gjitha gjërat, Ai krijoi një burrë dhe një grua që të bëheshin paraardhësit e parë të njerëzimit. Sidoqoftë, qeniet njerëzore duhej fillimisht të piqeshin dhe të merrnin bekimin e Zotit. Vetëm kështu ata do të ishin në pozitën e paraardhësve të vërtetë të njerëzimit. Fatkeqësisht, kjo nuk ndodhi dhe, si rezultat, sot ne kemi një njerëzim të rënë.



Për mijëra vjet, historia njerëzore ka qenë e mbushur me konflikte dhe përçarje. Unë kam ardhur për të përmbushur providencën e Zotit dhe jam duke qëndruar këtu përpara jush, në Shqipëri, si Bija e Vetëmlindur e Zotit dhe si Nëna e Vërtetë. Me sfidat e panumërta që shfaqen në botën e sotme, është e vështirë të ndjeni shpresë. OKB u themelua mbi shtatëdhjetë vjet më parë për hir të paqes botërore, por përse nuk i ka përmbushur ende përgjegjësitë e saj? Diçka themelore mungon. Kombet, si të mëdha ashtu edhe të vogla, nuk janë në gjendje të lënë mënjanë interesat e tyre vetjake dhe të bashkohen nën OKB. Situata është e njëjtë me Bashkimin Evropian. Si superfuqitë e botës, ashtu edhe kombet më të vogla kanë përparësi interesat e tyre kombëtare. Në këtë lloj bote, nuk ka dashuri të vërtetë apo jetë për hir të të tjerëve. Është e qartë se këto institucione dhe organizata të krijuara nga njeriu nuk mund të zgjasin përgjithmonë. Ne nuk mund të kemi sukses në realizimin e një të ardhmeje të bukur për tokën me metoda të përqendruara te njerëzit. Ka vetëm një rrugë drejt paqes; vetëm kur qëndrojmë në një pozitë nga ku i shërbejmë Zotit absolut, Krijuesit të universit, atëherë mund të lindë një botë paqeje.

Për të shpëtuar njerëzimin e rënë, Zoti ka lejuar që të ekzistojnë fe të shumta në mbarë botën. Të gjitha fetë kanë të njëjtin qëllim; të gjitha po shkojnë në

të njëtin drejtim. Secila prej tyre dëshiron të takojë Zotin, Pronarin e Krijimit.

Nuk ka përsosmëri në padituri. Ju duhet ta dini këtë. Nëse udhëheqësit e sotëm fetarë dhe politikë e duan popullin e tyre, ata duhet të dëgjojnë Zotin. Në mënyrë që Zoti të përfundojë providencën e Tij, në 1960, unë, si Bija e Vetme e lindur (e Zotit) duke ndjekur vullnetin e Tij, qëndrova në pozitën e një Prindi të Vërtetë bashkë me bashkëshortin tim. Njerëzimi i rënë është rezultat i prindërve të rremë. Për të përmbushur providencën e restaurimit, ne duhet të takojmë Prindërit e Vërtetë të përsosur në

tokë. Atëherë, ne mund të bëhemi fëmijë të Zotit Krijues, Prindit tonë Qiellor. Sot në gjithë botën ka njerëz që nuk e dinë se e vërteta është zbuluar. Që nga viti 1960, familjet e Bekuara janë shtrirë në më shumë se 192 vende. Ky themel përgatit skenën që Prindërit e Vërtetë të mirëpritën në nivel kontinental. Nëse dikush dëgjon të vërtetën, nëse dikush e kupton të vërtetën, si mund ta mohojë atë? A mundet një komb i tërë të mohojë të vërtetën?

Përmes Prindërve të Vërtetë, të gjithë njerëzit e rënë do të bëhen fëmijë të Prindit tonë Qiellor. Për Prindërit e Vërtetë, të gjitha kombet, të mëdha dhe të vogla, janë kombe simotra të bashkuara.

Do dëshiroja t'ju thoja këtë: Unë i di shpresat e kombeve në Gadishullin Ballkanik. Sidoqoftë, kur mendojmë për kontinentin Evropian, Shqipëria mund të konsiderohet si e fundit. Është shkruar në Bibël se «I pari do të jetë i fundit dhe i fundit do të jetë i pari.» Mos u zhgënjoni ngaqë nuk keni hyrë ende në Bashkimin Evropian. Shqipëria tani është e para, dhe ju mund ta përfaqëoni dhe t'i tregoni rrugën Evropës,

“
Shqipëria tani është e para, dhe ju mund ta përfaqëoni dhe t'i tregoni rrugën Evropës, e cila mund të bëhet e fundit.
”

cila mund të bëhet e fundit. Sa e mahnitshme është kjo e vërtetë? Zoti qoftë me ju kudo që të shkoni. Nëse Shqipëria kapërcen të gjitha vështirësitë e dhimbjet që ajo mban brenda dhe rilind si kombi qiellor i Shqipërisë që ndjek Zotin, Evropa mund të bëhet një. Bota e bëftë realitet ëndrrën e Prindit Qiellor dhe qoftë Shqipëria në pararojë të krijimit të një familje njerëzore nën bekimin dhe dashurinë e Zotit. Faleminderit.



Promovimi i librit të Dr. Hak Xha Han Mun, “Nëna e Paqes”

Tiranë

“NËNA E PAQES që fshin lotët e njerëzimit” titullohet libri që përmbledh rrugëtimin e jashtëzakonshëm të Nënës Mun, nga momentet e para të jetës së saj në një vend të shkatërruar nga lufta, përpjekja për mbijetesë duke u larguar si refugjate, bashkimi me bashkëshortin e saj Rev. Son Mjong Mun nën udhëheqjen e Zotit dhe rrugëtimin e tyre së bashku si Prindër të Vërtetë, për të sjellë shpresë dhe paqe në këtë botë të trazuar. Pas një përkushtimi intensiv për përkthimin e librit nga z. Sokol Rexhepi dhe përgatitjen e tij për botim nga stafi i Federatës, më 31 tetor, në mjediset e Hotel Tirana International u mbajt një takim i gjerë për promovimin e librit “Nëna e Paqes”. Mes 120 pjesëmarrësve ishin Anëtarë të Këshillit Drejtues të Federatës së Paqes Universale, Ambasadorë për Paqe, Familje të Bekuara dhe të rinj. Atmosfera ishte e mrekullueshme dhe programi i larmishëm bëri që koha të mos ndihej. Në fjalën e saj përshëndetëse, Kryetarja e Federatës së Paqes Universale Dr. Eva Çipi, tha:



“Ky libër është një dhuratë e çmuar, e cila na erdhi në një moment kritik të qenësisë dhe historisë së njerëzimit, ku shumë trazira po e sfidojnë paqen midis qytetarëve. Kjo dhuratë është ushqim shpirti dhe dritë për mendjen tonë. E bukur, e re, e ëmbël, por edhe e fortë, luftëtare, e paepur është imazhi i Nënës së Vërtetë, që të ndjek gjatë gjithë leximit të librit. Ti lexon e lexon, hyn në histori, imagjinon dhe përpiqesh të gjesh qenien tënde në krah të këtij modeli”.



Më pas dr. Saemira Pino, Kryetare e Komisionit të Akademikëve për Paqe pranë Federatës së Paqes dhe ish zëvendësministre e Arsimit dhe e Shëndetësisë, përcolli vlerësimet e saj për librin. Ndër të tjera, tha:

“Në këto kohë të vështira që po kalojmë ne, si edhe bota, na vjen në shqip, si një dritë për të na kujtuar se gjithmonë ka shpresë, libri me kujtime i Dr. Hak Xha Moon. Për nga kontributi me spektër të gjerë, Nëna Moon, mund të renditet ndër gratë më të shquara të kohës sonë. Për dekada të tëra vitesh përpiqet për bashkimin e dy Koreve dhe prosperitetin e tyre, ka mbajtur fjalë kurajoze për vlerat e besimit në Zot dhe antikomunizmin në vendet dikur komuniste, ka kontribuar në themelimit shkollash, gazetash, kompani biznesi, klinika e qendra shëndetësore, fabrika dhe ferma bujqësore, universitet, fondacione arsimore, akademi artistike etj. në të katër anët e globit. I ka rënë globit përfaqë dhe ka qenë e pranishme në 180 vende të tij”.



Vlorë

Në datën 27 nëntor 2020 Këshilli i Paqes Vlorë zhvilloi takimin online për promovimin e librit “Nëna e Paqes, që fshin lotët e njerëzimit”. Në aktivitet morën pjesë rreth 130 pjesëmarrës. Fjalët e referuara mbi librin ishin shumë frymëzuese dhe plot mesazhe.



Durrës

Më 19 dhjetor 2020 Këshilli i Paqes Durrës zhvilloi në ambientet e Federatës së Paqes aktivitetin për promovimin e librit me kujtime të Nënës së Paqes. Pas referimeve me vlerësime maksimale për vlerat e librit. Në fund të aktivitetit vlerësuan me titullin Ambasador për Paqe pesë personalitete të nderuara të qytetit të Durrësit.



Konferencë Virtuale

Udhëheqësit shpirtërorë: burim shprese dhe harmonie për njerëzit në kohë krizash



Haxhi Dede Edmond Brahimaj
Kryegjyshi Botëror i Bekdashinjve



Haxhi Bujar Spahiu
Kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë



At Gjergji Gjata
Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, Sarandë



Sheh Hysen Hormova
Kryetar i Tarikatit Halveti në Shqipërisë



Motër Bardhe Gjini
Kisha e Shën Marisë Riparuese, Vlorë



Imam Rexhep Lushta
Kryeimam i Mitrovicës, Kosovë



Bujar Topçiu
Kryetar i Komisionit Ndërfetar për Paqe dhe Zhvillim



Dr. Eva Çipi
Kryetare e Federatës së Paqes Universale Shqipëri

Më datë 12 dhjetor 2020, u zhvillua konferenca virtuale me temë “Udhëheqësit shpirtërorë, burim shprese dhe harmonie për njerëzit në kohë krizash”.

Një panel i nderuar përçolli mesazhe shpresë-dhënësë për zemrën e çdokujt. Personalitetet e nderuara që referuan ish-in përfaqësues nga të gjitha besimet fetare kryesore në Shqipëri, krahas kryetares së Federatës së Paqes Universale, dr. Eva Çipi, dhe kryetar të Komisionit Ndërfetar për Paqe dhe Zhvillim, FPU Shqipëri.



Këshilli Shqiptar i Paqes Gjermani

Pas një punë përgatitore intensive, Federata e Paqes Universale zhvilloi më datë 20 dhjetor 2020, konferencën virtuale në emër të Këshillit Shqiptar të Paqes për Gjermaninë ku morën pjesë figura të nderuara të diasporës shqiptare nga Gjermania, por pati përfaqësues edhe nga Austria, Anglia, Suedia dhe Belgjika. Aktiviteti u moderua nga Koordinatorin e Këshillave Shqiptare të Paqes në Diasporë Dr. Gaqo Apostoli.

Mesazhe përshëndetëse dhanë:


Z. Christia Hausmann, President i Federatës së Paqes Universale, Gjermani

Dr. Eva Çipi, Kryetare e Federatës së Paqes Universale, Shqipëri

Z. Ali Laçe, Bashkë-koordinator i Këshillit Shqiptar të Paqes

Z. Lavdrim Krashi, Kryetar i Këshillit Shqiptar të Paqes Angli

Në fund të aktivitetit, pas prezantimit të historikut të FPU në Shqipëri dhe Këshillit Shqiptar të Paqes nga Sekretari i Përgjithshëm i FPU z. Gani Rroshi, u nderuan me titullin Ambasador për Paqe 20 figura të nderuara të diasporës shqiptare, të cilët shprehën mirënjohjen e tyre për vlerësimin duke u motivuar për të punuar akoma më tepër në shërbim të paqes dhe promovimit të vlerave të kombit tonë.



Këshillat Shqiptare të Paqes në Diasporë, përveç Gjermanisë dhe Anglisë, janë krijuar edhe në Itali dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përkatësisht në Nju Jork dhe Filadelfia.



Ambasadë e Paqes për Shqipërinë dhe Ballkanin

Në vitin 2016 Shqipëria u përzgjedh për të ndërtuar një Ambasadë të Paqes e cila do të shërbejë jo vetëm për Shqipërinë dhe Kosovën, por për të gjithë Ballkanin. Ceremonia e fillimit të punimeve u mbajt në tetor 2019, gjatë kohës kur në Tiranë po zhvillonte punimet Samiti i Paqes për Evropën Juglindore. Përveç zyrave për departamentet e ndryshme të Federatës, Ambasada e Paqes do të ketë edhe një sallë konferencash me kapacitet 250 persona, sallë mbledhjesh dhe një bibliotekë për Ambasadorët për Paqe. Për shkak të vështirësive financiare të shkaktuara nga pandemia në nivel botëror, kërkohet nga Ambasadorët për Paqe dhe dashamirësit e Federatës së Paqes që të kontribuojnë për ta kompletuar këtë ndërtesë, për ta bërë atë ashtu siç ka edhe emrin; një vend të denjë për të përfaqësuar kombin dhe për të edukuar njerëzit. Të gjithë ata që do kontribuojnë, aq sa do të kenë mundësi, do të marrin një Certifikatë Mirënjohjeje për kontributin e tyre. Për kontribuesit e veçantë, emrat e tyre do të gdhenden në një pllakatë mirënjohjeje, që do të vendoset në një kënd të posaçëm në mjediset e Ambasadës së Paqes.

Si mund të kontribuoni?

Emri:	Federata e Familjes për Paqe Botërore
Numri i llogarisë:	0100559712 në Lekë (IBAN AL 2021 1013 0000 0001 0055 9712)
Numri i llogarisë:	8000325985 në Euro (IBAN AL64 2021 1013 0000 0080 0032 5985)
Banka:	Raiffeisen Bank
Përshkrimi:	Dhuratë për ndërtimin e Ambasadës së Paqes

Bordi i Revistës së Paqes

Dr. Eva Cipi
Z. Flamur Shehu
Z. Myzaljen Hoxha
Znj. Nora Malaj
Z. Abdulla Domi
Z. Dëfrim Methasani
Znj. Florenca Stafa
Znj. Marjeta Mërkuri
Znj. Suzana Numani
Znj. Marie Koliqi
Znj. Nada Bandilli
Z. Gjovalin Gjeloshi
Znj. Teuta Muçogllava
Znj. Donika Hysenaj
Znj. Mimoza Llavdaniti

Znj. Rajmonda Stefa
Dr. Astrit Memia
Dr. Niko Veizaj
Znj. Majlinda Mema
Dr. Gaqo Apostoli
Z. Ali Laçej
Znj. Manjola Vasmatits
Dr. Saemira Pino
Znj. Lavdie Ruci
Prof. Dr. Mimoza Hafizi
Z. Elsa Xhai
Z. Bujar Topçiu
Z. Ardian Hasku
Z. Arjan Haziraj
Z. Gani Rroshi





Rr. "Budi", Pallati 29, Kati 2, Nr. 10
Tiranë, Shqipëri
Phone: +355 692 060 270
Email: upf.albania@gmail.com